



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ambienti” Sh.P.K. të datës 03.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e” me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ambienti” Sh.P.K. të datës 03.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e” me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.**
- II. LEJOHET autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.**
- III. NJOFTOHEN palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ambienti” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 03.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e” me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Përmes kësaj shkrese, ju drejtohem me kërkesë për rishqyrtim lidhur me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara për mjetet në kuadër të Lotit 1, me qëllim që kërkesat teknike të jenë të arsyeshme, proporcionale dhe të mundësojnë konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Pas shqyrtimit të kërkesave të përcaktuara, kemi vërejtur disa pika të cilat, sipas vlerësimit tonë, duhet të rishikohen, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me numrin, llojin, kapacitetin dhe peshën e mjeteve. Konkretisht, kërkojmë rishqyrtimin e këtyre pikave LOTO 1 Pika 2 - Nga pershkrimi I bere nga Ak jan fikse kriteret mendoj se duhet te jen 1.5 deri 2.5 qe te kete konkurence ne loto. Pika 3 – Nga pershkrimi I AK pashia eshte 2.0 deri 2.7 mendoj se duhet te jene min 3max. Pika 6 – Nga pershkrimi I AK tek kjo pike eshte bere pashia totale deri 4.5 ku e njehta pike tek loto 3 eshte bere 3.5 deri ne 5.5, mendoj se dhe kjo pjes duhet et rishikohet. Pika 7 – Nga pershkrimi I AK kombi special 3.5 deri 5 ku ne disa pika eshte kerkuara 3 deri 5. Pika pika 9 nga mini 9000max 20000 kur ne llotin 2 mjeti i njejt osht kerku nga 7000deri 10000 mendojm se duhet te jet si ne llotin 2 a ndersa ne llotin 3 osht kerku 3000 ashtu edhe ne llotin 4 3000 kurse ne llotin 5 9000deri 20000 lloti 3 pika 4 eskavator me goma mini 19 max 21 kur ne llotin 1 pika 12 osht kerku 8-10 si dhe ne llotin 6 pika 9 osht 8-10 mendoj se edhe lloti 3 duhet te jetn 8-10".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast janë kërkuar sqarime pikërisht nga njësia kërkuese të cilave u është falur besimi i plotë. Sqarime e ofruara nga njësia kërkuese lidhur me pretendimet ankimore janë si në vijim:

"1. Pika – Fshesa 1.5–1.9 ton

Pretendimi/kërkesa:

Operatori kërkon që intervali 1.5–1.9 ton të bëhet 1.5–2.5 ton për të rritur konkurrencën.

Përgjigjja e AK-së:

REFUZOHET. Kjo kategori është përcaktuar posaçërisht për shtigje biçikletash dhe trotuare me qasje të kufizuar. Dosja kërkon edhe furça/vakum, depozitë së paku 240 L, gjerësi pune me brusha mbi 1.5 m dhe rezervuar uji mbi 150 L. Pësia nuk është parametër i izoluar; ajo lidhet me kategorinë kompakte dhe manovrueshmërinë. Në territorin e LOT-I ekzistojnë segmente të shtigjeve të biçikletave rreth 1.5–1.9 m, sipas matjeve orientuese të terrenit. Këto nuk paraqiten si matje zyrtare gjeodezike dhe mund të verifikohen në terren dhe përmes Gjeoportalit aty ku të dhënat janë të disponueshme. Lejimi deri në 2.5 ton nuk është provuar nga operatori se garanton të njëjtën manovrueshmëri në të gjitha këto segmente. Vetëm deklarimi se kjo 'rrit konkurrencën' nuk provon se kërkesa aktuale është e panevojshme.

2. Pika – Fshesa kompakte 2.0–2.7 ton

Pretendimi/kërkesa:

Operatori kërkon që fshesa të jetë minimum 3 ton.

Përgjigjja e AK-së:

REFUZOHEM. Kjo kategori mbulon trotuare, rrugë urbane dhe hapësira publike dhe është menduar si kategori e ndërmjetme ndërmjet fshesës shumë kompakte dhe fshesave 3-6 ton. Ngritja e pragut në 3 ton do të eliminonte nga kjo kategori mjetet kompakte që janë të nevojshme në hapësira urbane me qasje dhe manovrim të kufizuar. Një pajisje më e rëndë mund të kryejë funksionin e fshirjes, por kjo nuk dëshmon se është e barasvlershme për kushtet konkrete të LOT-I.

3. Pika 6 – Kamioneta për bartjen e mbeturinave deri në 4.5 ton

Pretendimi/kërkesa:

Operatori kërkon rishikim duke e krahasuar me specifikimin e një LOT-i tjetër.

Përgjigjja e AK-së:

REFUZOHEM. Në LOT-I kërkohen dy kamioneta deri në 4.5 ton, me kuti të mbyllur, kapacitet ngarkese të përshtatshëm për operim urban dhe sistem efikas ngarkimi/shkarkimi. Qëllimi është grumbullimi dhe transporti i mbetjeve nga shportat publike dhe hapësirat urbane me frekuentim të lartë. Dallimi nga një LOT tjetër nuk është provë e diskriminimit, sepse nevoja territoriale, numri i pikave, distancat dhe organizimi i shërbimit mund të jenë të ndryshme.

4. Pika 7 – Kombi special 3.5-5 ton

Pretendimi/kërkesa:

Operatori kërkon rishikim sepse në disa LOT-e ka interval 3-5 ton.

Përgjigjja e AK-së:

REFUZOHEM. Në LOT-I kërkohen dy kombi 3.5-5 ton me presion minimal 120 bar, kapacitet uji minimal 1,000 L, peshë bartëse të dëshmuar dhe gyp minimal 50 m. Këto parametra së bashku sigurojnë mjet të aftë për qasje në zona urbane dhe për kryerje reale të deblokimit. Gjatësia 50 m është veçanërisht e rëndësishme sepse mjeti jo gjithmonë mund të afrohet fizikisht deri te puseta ose grila. Po ashtu, presioni minimal është vendosur për të shmangur situatat e mëparshme ku operatori nuk mund ta realizojë funksionin për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm.

5. Pika 8 e Aneksit 8 – Cisternë e kombinuar 9,000-20,000 L

Pretendimi/kërkesa:

Operatori e referon si Pika 9 dhe kërkon që të jetë si në LOT-II, ku ka kapacitet tjetër.

Përgjigjja e AK-së:

REFUZOHEM. Për saktësi, në Dosjen e Tenderit të korrigjuar më 28.08.2026, mjeti 9,000-20,000 L figuron si Pika 8. Mjeti kërkohet me ndarje minimale 4,500 L për thithje dhe 4,500 L për deblokim, presion minimal 120 bar, gyp minimal 50 m për deblokim dhe 7 m për thithje. Kjo është një pajisje e kombinuar me kapacitet të lartë dhe funksion të dyfishtë. Krahasimi vetëm me kapacitetin e një mjeti në LOT tjetër nuk dëshmon ekuivalencë. Për të pranuar kërkesën e operatorit do të duhej të provohej se mjeti alternativ ka të njëjtin funksion, konfigurim, kapacitet operativ, qasje dhe produktivitet në kushtet konkrete të LOT-I.

6. Pika 12 – Eskavator me goma 8-10 ton

Pretendimi/kërkesa:

Operatori kërkon që specifikimi i LOT-III për 19-21 ton të zëvendësohet me 8-10 ton, duke e krahasuar me LOT-I dhe LOT-VI.

Përgjigja e AK-së:

REFUZOHET. Në LOT-I kërkohet një eskavator me goma 8-10 ton, me lugë ngarkuese përpara, krah gërmues prapa dhe sistem hidraulik funksional, i përshtatshëm për terren urban, kanalizim dhe ndërhyrje në shembje dheu. Nëse një LOT tjetër kërkon 19-21 ton, kjo lidhet me nevoja të tjera pune dhe nuk krijon detyrim që LOT-I të ndryshojë specifikimin e vet. Për më tepër, kjo pikë e kërkesës së operatorit lidhet kryesisht me LOT-III dhe nuk paraqet argument për ndryshimin e mjetit të përcaktuar për LOT-I.

PARIMI 'NJË MAKINË MUND TA BËJË TË NJËJTËN PUNË' NUK MJAFTON

AK thekson se ekuivalenca funksionale nuk mund të vlerësohet vetëm në nivelin e emërimit të funksionit. Për një shërbim urban, duhet të vlerësohen së bashku dimensionet, manovrueshmëria, kapaciteti, presioni, gjatësia e gypave, qasja, siguria, produktiviteti dhe vazhdimësia. Prandaj, fakti që një makinë tjetër mund të 'fshijë', 'larë' ose 'debllokojë' nuk e provon se ajo mund ta kryejë atë funksion në çdo segment të LOT-I."

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.